



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 535/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-71743-05-28-2018, me objekt: “Blerje tonera për nevoja të Shoqërisë”, me fond limit 5.199.986 Lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.06.2048 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk  
Adresa: Lagjia 6 Rruga: “Shoqëria Bashkimi” Pallati Clas, Kati 1 Durrës.

**Autoriteti Kontraktor:** Ujesjellës Kanalizime Tiranë sh.a.  
Adresa : Rruga “5 Maj”, prane Medresesë Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010

*“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”; i ndryshuar

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.05.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-71743-05-28-2018, me objekt: “*Blerje tonera për nevoja të Shoqërisë*”, me fond limit 5.199.986 Lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.06.2048 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, në datën 01.06.2018, operatori ekonomik ankimues “*Erisoni Company*” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

Në datën 29.05.2018 pasi u njohëm me dokumentat e tenderit në sistemin e APP-së me objekt “Blerje tonera për nevoja të Shoqërisë”, nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha paraqesim këtë formular ankese brenda afateve ligjore sipas parashikimeve të nenit 63 të LPP-së[...]. Në dst për kapacitetin teknik dhe profesional pika 4 kërkohet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.” Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim. Në bazë të shtojcës 10 të dst-ve përshkrimi dhe sasia e mallrave si më poshtë:

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi pa t.v.sh"
1	Kyocera TK 170	cope	40	
2	Kyocera TK 1130	cope	50	
3	Kyocera Taskalfa 3010i	cope	50	
4	Kyocera Taskalfa 5501i	cope	40	
5	HP 51 A	cope	25	
6	Toshiba estudio 222cp	set	3	
7	HP 78 A	cope	10	
8	HP 85 A	cope	15	
9	HP 82	set	5	
10	Richo Affico MP 2000	cope	25	
11	Xerox Phaser 3330( 106R03621)	cope	50	
12	Richo Affico MP 3350	cope	10	
13	Samsung ML 1915	cope	50	
14	OKI MB 461	cope	20	
15	OKI B 432	cope	50	
16	Kyocera TK 580	set	5	
17	HP 35 A	cope	40	
18	HP 64A	cope	10	
19	Toshiba TFC -50	set	15	
20	Samsung SCX 4300	cope	10	
21	ëaster Toner Toshiba TB -FC50E	cope	10	
22	Toner lexmark Opta T 420 PN 12A 7410	cope	1	
23	Toner lexmark IBM 4019 PN 1380200	cope	1	
24	Canon Toner CLC-300	set	1	
25	Xerox Phaser 3200 Blt 3K High capacity	cope	1	
	TOTALI PA T.V.SH			
	T.V.SH			

TOTALI ME T.V.SH			
------------------	--	--	--

Në bazë të tabelës së mallrave numri rendor 23 që përkon me Toner lexmark IBM 4019 PN 1380200 në faqen zyrtare të Lexmark nuk gjendet pasi është një model shumë i vjetër. Bashkëngjitur linku [...]

Edhe numri rendor 24 në tabelën e mallrave që përkon me Canon Toner CLC-300 nuk është e disponueshme, pasi kjo makinë është një makinë analoge dhe jo dixhitale që ka 20 vjet që ka dalë nga qarkullimi tregut dhe faqja zyrtare e Canon ky model toneri nuk ekziston më.

Bashkëngjitur linku[...]

Në bazë të informacioneve që kemi UKT sha nuk disponon këto makina pasi 2 vitet e fundit në dst në tabelën e përshkrimit të mallrave nuk kanë këto 2 lloj tonerash. Nuk kanë sit ë blihen këto dy modele makinash analoge që janë hequr nga qarkullimi tregut prej 20 vitesh dmth nuk ekzistojnë.

Ky kriter kualifikimi është në kundërshtim të hapur me LPP-në neni 1 neni 2, neni 20 dhe 46;

Kërkojmë nga AK-ja të hiqet kjo kërkesë për këto 2 lloj modele tonerashpasi nuk janë në qarkullim.

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. K-2466/1 prot., datë 04.06.2018, duke mos pranuar atë.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...]

Me marrjen e ankesës nga ana e shoqërisë “Erisoni Company” sh.p.k., KSHA-ja mori në shqyrtim ankesën e paraqitur pranë UKT sha.

Në ankesën e paraqitur operatori ekonomik kundërshton vendosjen e kërkesave për tonera dhe konkretisht për zërat me nr. Rendor 23 i cili përkon Toner lexmark IBM 4019 PN 1380200.

Gjithashtu shfaqni të njëjtin pretendim edhe për zërin me nr. Rendor 24 i cili përkon me tonerin Canon Toner CLC-300 i cili sipas jush nuk është në qarkullim.

KSHA referuar pretendimit të shoqërisë se tonerat e kërkuara në dst përkatësisht zërat Lexmark IBM 4019 PN 1380200; Canon Toner CLC-300 nuk ekzistojnë sqarojmë se pranë ukt sha ekzistojnë këta printera për të cilët po ju bashkëngjisim edhe foto të këtyre printerave dhe shumë të tjerë që janë akoma me të vjetër se këta modele). Përveç Lexmark IBM 4019 PN 1380200; Canon Toner CLC-300 janë edhe printera të tjerë si Rex Rotary 8715z+; Brother model HL -51, Oki 6500, Lexmark T420; Lexmark E120; janë modele akoma më të vjetër se dy modelet që kemi vendosur me diferencë prej 20 vitesh. Të gjithë këto modele ekzistojnë dhe janë të verifikueshme në Magazinat e Brar (Abient i UKT-së sha) ku gjithsesëcili mund të vijë të shikojë dhe të bëjë verifikimet e nevojshme. Gjithashtu në studimin e tregut nga grupi i punës rezulton se ofertuesit kanë vendosur cmimet për këto tonera. KSHA-ja gjykon se përderisa ofertuesit në cmimet depozitura pranë UKT sha kanë ofertuar edhe për tonerat Lexmark IBM 4019 PN 1380200; Canon Toner CLC-300 do të thotë që ekzistojnë. Për sa më sipër përfundimisht KSHA-ja gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.[...]

II.4. Në datën 06.06.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 19.06.2018, nëpërmjet shkresës me nr.K-2618/1 prot., datë 18.06.2018, protokolluar me tonën nr. 1067/2prot., datë 19.06.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k.

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri: “Në dst për kapacitetin teknik dhe profesional pika 4 kërkohet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.” Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim. Në bazë të shtojcës 10 të dst-ve përshkrimi dhe sasia e mallrave si më poshtë: Referojmë shtojcën 10 të DST-ve [.....]

Në bazë të tabelës së mallrave numri rendor 23 që përkon me Toner lexmark IBM 4019 PN 1380200 në faqen zyrtare të Lexmark nuk gjendet pasi është një model shumë i vjetër. Bashkëngjitur linku [...]

Edhe numri rendor 24 në tabelën e mallrave që përkon me Canon Toner CLC-300 nuk është e disponueshme, pasi kjo makinë është një makinë analoge dhe jo dixhitale që ka 20 vjet që ka dalë nga qarkullimi tregut dhe faqja zyrtare e Canon ky model toneri nuk ekziston më.

Bashkëngjitur linku [...]

Në bazë të informacioneve që ankimuesi zotëron se UKT sha nuk disponon këto makina pasi 2 vitet e fundit në dst në tabelën e përshkrimit të mallrave nuk kanë këto 2 lloj tonerash dhe se këto nuk kanë si të blihen pasi këto dy modele makinash analoge janë hequr nga qarkullimi tregut prej 20 vitesh dmth nuk ekzistojnë.

Ankimuesi pretendon se ky kriter kualifikimi është në kundërshtim të hapur me LPP-në neni 1 neni 2, neni 20 dhe 46; dhe se ka kërkuar nga autoriteti kontraktor që kjo kërkesë të hiqet pasi këto 2 lloj modele tonerash nuk janë në qarkullim” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, pika 4, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.*

*Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim.*

III.1.2. Referuar, shtojcës 10 të dokumenteve të tenderit, në sasia dhe grafiku i mallrave, autoriteti kontraktor ka parashikuar sasisnë e mallit që kërkohet si më poshtë vijon:

*Sasia e mallit që kërkohet:*

<i>Nr</i>	<i>Pershkrimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi pa t.v.sh"</i>
1	<i>Kyocera TK 170</i>	<i>cope</i>	40	
2	<i>Kyocera TK 1130</i>	<i>cope</i>	50	
3	<i>Kyocera Taskalfa 3010i</i>	<i>cope</i>	50	
4	<i>Kyocera Taskalfa 5501i</i>	<i>cope</i>	40	
5	<i>HP 51 A</i>	<i>cope</i>	25	
6	<i>Toshiba estudio 222cp</i>	<i>set</i>	3	
7	<i>HP 78 A</i>	<i>cope</i>	10	
8	<i>HP 85 A</i>	<i>cope</i>	15	
9	<i>HP 82</i>	<i>set</i>	5	
10	<i>Richo Affico MP 2000</i>	<i>cope</i>	25	
11	<i>Xerox Phaser 3330( 106R03621)</i>	<i>cope</i>	50	
12	<i>Richo Affico MP 3350</i>	<i>cope</i>	10	
13	<i>Samsung ML 1915</i>	<i>cope</i>	50	
14	<i>OKI MB 461</i>	<i>cope</i>	20	
15	<i>OKI B 432</i>	<i>cope</i>	50	
16	<i>Kyocera TK 580</i>	<i>set</i>	5	
17	<i>HP 35 A</i>	<i>cope</i>	40	
18	<i>HP 64A</i>	<i>cope</i>	10	
19	<i>Toshiba TFC -50</i>	<i>set</i>	15	
20	<i>Samsung SCX 4300</i>	<i>cope</i>	10	
21	<i>Ëaster Toner Toshiba TB -FC50E</i>	<i>cope</i>	10	
22	<i>Toner lexmark Opta T 420 PN 12A 7410</i>	<i>cope</i>	1	



23	Toner lexmark IBM 4019 PN 1380200	cope	I	
24	Canon Toner CLC-300	set	I	
25	Xerox Phaser 3200 Blt 3K High capacity	cope	I	
	TOTALI PA T.V.SH			
	T.V.SH			
	TOTALI ME T.V.SH			

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrveshjes kuadër. Levrimi do te behet sipas kerkeses dhe nevojës se Autoritetit Kontraktor.

Në shtojcën 9 “Specifikimet Teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### Garancia

Bojërat duhet të jenë origjinale, jocompatible, të mos jenë të rimbushura, të mos jenë të ricikluara, të mos jenë të riprodhuara, të jenë të paketuara, të pahapura.

Tonerat të jenë të shoqëruara me pullë sigurie nga prodhuesi. Emri i prodhuesit të jetë i stampuar si në kutinë e bojës, në pullën e sigurisë si dhe në kartrixhe.

Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës.

#### Grafiku i lëvrimit:

Artikujt duhet të dorëzohen në magazinën e Ujësjellës Kanalizime Tiranë me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

III.1.4. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e synimit të këtij autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kriteret kualifikimi me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Akoma më tej KPP konstaton se, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit si edhe akti administrativ nr.K-2618/1 prot., datë 18.06.2018, dërgim informacioni dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në të cilin autoriteti kontraktor në mënyrë të përmbldhur argumenton se: “[...]Në ankesën e paraqitur operatori ekonomik kundërshton vendosjen e kërkesave për tonera dhe konkretisht për zërat me nr. Rendor 23 i cili përkon Toner lexmark IBM 4019 PN 1380200 dhe për zërin me nr. Rendor 24 i cili përkon me tonerin Canon Toner CLC-300, pasi pretendon se këto tonera nuk ekzistojnë në qarkullim.

KSHA referuar pretendimit të shoqërisë se tonerat e kërkuara në dst përkatësisht zërat Lexmark IBM 4019 PN 1380200; Canon Toner CLC-300 nuk ekzistojnë ka sqaruar se pranë UKT sh.a. ekzistojnë këta printera për të cilët janë bashkëngjitur edhe foto të këtyre printerave dhe shumë të tjerë që janë akoma me të vjetër se këta modele). Përveç Lexmark IBM 4019 PN 1380200; Canon Toner CLC-300 janë edhe printera të tjerë si Rex Rotary 8715z+; Brother model HL -51, Oki 6500, Lexmark T420; Lexmark E120; janë modele akoma më të vjetër se dy modelet që kemi vendosur me diferencë prej 20 vitesh. Të gjithë këto modele ekzistojnë dhe janë të verifikueshme në Magazinat e Brar (Abient i UKT-së sha) ku gjithsesë mund t'i shikojë dhe të bëjë verifikimet e nevojshme. Gjithashtu në studimin e tregut nga grupi i punës rezulton se ofertuesit kanë vendosur cmimet për këto tonera. KSHA-ja gjykon



se përderisa ofertuesit në cmimet e depozitura pranë UKT sha kanë ofertuar edhe për tonerat Lexmark IBM 4019 PN 1380200; Canon Toner CLC-300 do të thotë që ekzistojnë. Për sa më sipër përfundimisht KSHA-ja gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.[...],” Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij si më sipër cituar, për të kërkuar mostrat e mallrave objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, të cilat edhe këto nga ana tjetër duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor. KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-71743-05-28-2018, me objekt: “Blerje tonera për nevoja të Shoqërisë”, me fond limit 5.199.986 Lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.06.2048 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.
  2. Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1067 Protokoli, Datë 06.06.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**